

Krye 11.

- 1 Edhe gjithë dheu kishte një gjuhë e një
 2 të-folurë. Edhe kur unisnë nga ana që lint
 djelli, gjetnë një fushë ndë dhet të Shenaa-
 3 rit: edhe ndënjnë atje. Edhe i thanë shoqi
 shoqit, Eni, letë bëjmë pëqisa, e let' i pjekmë
 ndë zjarr. Edhe kishinë pëqisa ndë vëntt të
 gurëvet, edhe kishinë pisë ndë vëntt të baltësë.
 4 Edhe thanë, Eni, letë ndërtojmë për vetëhenë
 t'ënë një qytet e një pirk, maj' e të-cilit të
 arrinjë gjer ndë qiellt; edhe letë fitojmë për

- vetëhenë t'ënë emërë; semos përndahemi mbi
 faqet të gjithë dheut.
- 5 Edhe Zoti sbriti që të shihte qytetnë edhe
 6 pirgunë, që ndërtuanë të bijt' e njerëzet. Edhe
 Zoti tha, Na këta tek janë një gjindje, edhe
 të-gjithë kanë një gjuhë, edhe zunë të bënjenë
 këtë, edhe tashi asgjë nukë dot' i ndalonjë ata
 të bënjenë gjithë ç' kanë menduarë për të bërë;
 7 Eni, letë sbresmë, edhe letë përzejmë atje
 gjuhën' e atyreve, që të mos i kupëtonjë njëri
 fjalënë tjetërit.
- 8 Kështu Zoti që andej i përndau ata mbi
 faqet të gjithë dheut; edhe ata e lanë të-ndër-
 9 tuarët' e qytetit. Përandaj uquajt emëri i atij
 Babel (të-përzjerë); sepse Zoti atje përzjeu
 gjuhën' e gjithë dheut; edhe që andej Zoti i
 përndau ata mbi faqet të gjithë dheut.
- 10 Këjo është gjeneallogjia e Shimit. Shimi
 ishte një qint vjeç, kur i lindi Arfakshadi, dy
 11 vjet pas përmytjesë; Edhe Shimi rroj, passi
 i lindi Arfakshadi, pesë qint vjet, edhe i lint-
 në bij e bija.
- 12 Edhe Arfakshadi rroj tridhjet' e pesë vjet,
 13 edhe i lindi Shellau; Edhe Arfakshadi, rroj,
 passi i lindi Shellau, katër qint e tre vjet,
 edhe i lintnë bij e bija
- 14 Edhe Shellau rroj tri-dhjetë vjet, edhe i
 15 lindi Eberi; Edhe Shellau rroj, passi i lindi
 Eberi, katër qint e tre vjet, edhe i lintnë bij
 e bija.

- 16 Edhe Eberi rroj tri-dhjet' e katrë vjet, edhe
 17 i lindi Falegu; Edhe Eberi rroj, passi i lindi
 Falegu, katrë qint e tri-dhjetë vjet, edhe i
 lintnë bij e bija.
- 18 Edhe Falegu rroj tri-dhjetë vjet, edhe i
 19 lindi Reuj; Edhe Falegu rroj, passi i lindi
 Reuj, dy qint e nëntë vjet, edhe i lintnë bij
 e bija.
- 20 Edhe Reuj rroj tri-dhjet' e dy vjet, edhe
 21 i lindi Serugu; Edhe Reuj rroj, passi i lin-
 di Serugu, dy qint e shtatë vjet, edhe i lint-
 në bij e bija.
- 22 Edhe Serugu rroj tri-dhjetë vjet, edhe i
 23 lindi Nahori; Edhe Serugu rroj, passi i lindi
 Nahori, dy qint vjet, edhe i lintnë bij e bija.
- 24 Edhe Nahori rroj njëzet e nëntë vjet, edhe
 25 i lindi Tharaj; Edhe Nahori rroj, passi i lin-
 di Tharaj, një qint e nëntë-mbë-dhjetë vjet,
 edhe i lintnë bij e bija.
- 26 Edhe Tharaj rroj shtatë-dhjetë vjet, edhe
 i lindi Abrami, Nahori, e Harani.
- 27 Edhe këjo është gjenealogja e Tharajt;
 Tharajt i lindi Abrami, e Nahori, e Harani;
 28 edhe Haranit i lindi Lloti. Edhe Harani vdiq
 përpara Tharajt, t' et, ndë vënt të të-lindurit
 të tij, ndë Urë të Halldhenjvet.
- 29 Edhe Abrami e Nahori muarrë gra për
 vetëhen' e tyre; emëri i gruas' s' Abramit ish-
 te Sarë; edhe emëri i gruas' së Nahorit ishte
 Mellha, e bij' e Haranit, t' et të Mëllhasë, edhe

- 30 t' et të Jiskasë. Edhe Sara ishte shterpë; s'
 kishte fëmijë.
- 31 Edhe Tharaj mori Abramnë, të birrë, edhe
 Llotnë, të birin' e Haranit, të nipnë, edhe Sa-
 rënë, të-ren' e tij, gruan' e të birt Abram; e-
 dhe duallë bashkë nga Ura e Halldhenjvet,
 që të venë ndë dhet të Hanaanit; edhe erth-
 në gjer ndë Harran, edhe ndënjnë atje.
- 32 Edhe ubënë ditt' e Tharaj dy qint e pesë
 vjet; edhe Tharaj vdiq ndë Harran.

Krye 12.

- 1 Edhe Zoti i tha Abramit, Dil nga dheu
 yt, edhe nga fisi yt, edhe nga shtëpia e t' yt
 2 et, nd' atë dhe që dotë të dëftenj ty; Edhe
 dotë të bënj ty një komp të-math, edhe dotë
 të bekonj, edhe dotë madhëronj emërinë t' ënt;
 3 edhe dotë jesh për bekim; Edhe dotë bekonj
 ata që të bekonjënë ty, edhe dotë mallëkonj
 ata që të mallëkonjënë ty; edhe mbë ty dotë
 bekonenë gjithë farat' e dheut.
- 4 Kështu Abrami vate, sikundrë i foli Zoti
 atij; edhe bashkë me atë vate edhe Lloti.
 Edhe Abrami ishte shtatë-dhjet' e pesë vjet
 5 ndë moshë, kur dolli nga Harrani. Edhe A-
 brami mori Sarënë, gruan' e tij, edhe Llotnë,
 të birin' e të vëllajt, edhe gjithë gjën' e tyre
 sa kishinë fituarë, edhe njerëzitë që kishinë
 fituarë ndë Harran, edhe duallnë që të vi-

ninë ndë dhet të Hanaanit; edhe erthnë ndë dhet të Hanaanit.

- 6 Edhe Abrami shkoj ndëpër atë dhe gjer ndë vëntt të Shiqemit, gjer ndë list të Morehut. Edhe Hanaanitëtë atëhere rrininë ndë
- 7 *këtë* dhe. Edhe Zoti i uduk Abramit, e tha, Farësë s'ate dot' j'a ap këtë dhe. Edhe Zotit që i uduk atij i ndërtoj atje një therore.
- 8 Edhe q'andej vate ndë malt, që është nga ana e të-lindurit të djellit të Vethilësë, edhe ngrehu tëndën' e tij, që kishte Vethilënë nga perëndon djelli, edhe Gainë nga lint djelli; edhe i ndërtoj atje një therore Zotit, edhe thërriti mb' emërin' e Zotit.
- 9 Edhe Abrami ungrit q'andej dyke bër' udhë e dyke vaturë nga an' e mes-ditësë.
- 10 Edhe ubë zi buke nd' *atë* dhe; edhe Abrami sbriti nd' Egjyptë për të ndënjur' atje; sepse zia ishte e-keqe ndë dhet.
- 11 Edhe *Abrami*, kur uafërua të hynte nd' Egjyptë, i tha Sarësë, gruas' së tij, Na tek
- 12 e di se je grua e-bukurë ndë të-parë; Edhe mundetë, kur të të shohënë Egjyptianëtë, të thonë, Këjo është gruaja e atij, edhe mua të më vrasënë, po ty të të ruanjënë të-gjallë.
- 13 Thuaj, të lutem, *se* je ime motërë, që të bënetë mirë për mua nga puna jote, edhe të më ruhetë jeta për tynë.
- 14 Edhe posa hyri Abrami nd' Egjyptë, Egjyptianënë panë gruanë se ishte fort e-bukurë.

- 15 Edhe të-parët' e Faraojt e pan' atë, edhe j'a lëvduanë Faraojt; edhe umuar gruaja ndë
- 16 shtëpit të Faraojt. Edhe për punë t' asaj Abramnë e mori me të-mirë; edhe *kështu* pat dhën, e qe, e gomarë, e shërbëtorë, e shërbëtore, e gomare, e kamilla.
- 17 Edhe Zoti nga pun'e Sarësë, gruas' së Abramit, plagosi Faraonë e shtëpin' e atij me
- 18 plagë të-mëdha. Edhe Faraoj thirri Abramnë, e tha, Ç' është këjo që më bërë? përse nukë
- 19 më dëfteve se këjo është gruaja jote? Përse the, Ime motërë është këjo? *edhe* kështu e mora grua për vetëhenë t'ime; edhe tashi, na gruaja jote; merr-e, edhe shko.
- 20 Edhe Faraoj urdhëroj njerës për atë; edhe *ata* e përcualln' atë, edhe gruan' e atij, edhe gjithë ç' kishtë.

Krye 13.

- 1 Edhe Abrami ungjiti nga Egjypta, ay, edhe gjithë ç' kishte, edhe Lloti bashkë me atë,
- 2 mb'anët të mes-ditësë. Edhe Abrami ishte fort i-pasurë me bagëti, me ergënt, e me ar.
- 3 Edhe vate dyke bërë udhë nga an'e mes-ditësë gjer ndë Vethilë, gjer nd' *atë* vënt ku qe tenda e atij më përpara, ndër mest të
- 4 Vethilës' e të Gaisë; Ndë vëntt të theroresë që pat bërë atje herën' e-parë; edhe Abrami thirri atje mb' emërin' e Zotit.
- 5 Po edhe Lloti që ecënte bashkë me A-

- 6 bramnë kishte dhën, e qe, e tenda. Edhe vëndi nuk' i nxinte ata, që të rrininë bashkë; sepse kishinë shumë gjë, kaqë sa s' muntninë
- 7 të rrininë bashkë. Edhe gjajti një qartë ndër mest të barinjvet të bagëtivet t' Abramit e të barinjvet të bagëtivet të Llotit. Edhe Hanaanitët' edhe Ferezitëtë atëhere rrininë nd' atë dhe.
- 8 Edhe Abrami i thotë Llotit, Të lutem, letë mos jetë qartë ndër mest meje e teje, e ndër mest të barinjvet të mi e të barinjvet të tu;
- 9 sepse neve jemi vëllezër. A nuk' është gjithë vëndi përpara teje? ndahu, të lutem, prej meje; ndë *vafsh* ti nga an' e-mëngjërë, unë dotë vete nga an' e-djathtë; a ndë *vafsh* ti nga an' e-djathtë, unë dotë vete nga an' e-mëngjërë.
- 10 Edhe Lloti ngriti syt' e tij, e pa gjithë fushën' e Jordanit, se ujitej mirë kudo, para se të prishte Zoti Sodomat' e Gomorratë, posi kopështi i Zotit, posi dheu i Egjyptësë, kur
- 11 vete njeriu ndë Zoarë. Kështu Lloti sgjodhi për vetëhen' e tij gjithë fushën' e Jordanit, edhe Lloti ungrit e vate mb' anët që lint djelli; edhe undanë njëri prej tjetërit.
- 12 Abrami ndënji ndë dhet të Hanaanit, edhe Lloti ndënji ndër qytetet të fushësë, edhe
- 13 nguli tendat' e ti gjer ndë Sodhomat. Po njerëzit' e Sodhomavet ishinë të-liq edhe fajtorë kundrë Zotit fort tepërë.
- 14 Edhe Zoti i tha Abranit, passi unda Lloti

- prej atij, Ngre syt' e tu tashi, edhe shih nga vëndi që je, drejt borës' e mes-ditës' e të-lindurit e të-perënduarit të djellit; Sepse gjithë
- 15 *këtë* dhe që sheh ty t'a kam për të dhënë,
- 16 edhe farësë s' ate për gjithë jetënë. Edhe dotë bënë farënë t' ende posi rërën' e dheut, kaqë sa ndë munt ndonjë të numëronjë rërën' e dheut, atëhere dotë numëronet' edhe fara jote.
- 17 Ngreu, e ecë ndëpër dhet për së-gjati e për së-gjeri; sepse ty t'a kam për të dhënë atë.
- 18 Edhe Abrami ngriti tendën' e tij, edhe erdhi e ndënji ndaj lisavet të Mamrisë, të-cilëtë janë ndë Hebron; edhe i ndërtoj atje Zotit një therore.

Krye 14.

- 1 Ndë ditt të Amarfelit, mbretit të Shenaarit, të Ariohut, mbretit t' Ellasarit, të Qedorllaomerit, mbretit t' Ellamit, edhe të Tidallit,
- 2 mbretit të kombevet, Këta bënë luftë me Beranë, mbretin' e Sodhomavet, edhe me Birsanë, mbretin' e Gomorravet, me Shinabinë, mbretin' e Admasë, edhe me Shemeberinë, mbretin' e Seboimvet, edhe me mbretin' e
- 3 Bellasë (këjo është Zoara). Këta të-gjithë umblohnë bashkë ndë fushët të Siddimit, që
- 4 është Deti i-Kripurë. Dy-mbë-dhjetë vjet i shërbeninë Qedorllaomerit; edhe mbë të-tre-
- 5 mbë-dhjetinë vit ngritnë krye. Edhe mbë të- katrë-mbë-dhjetinë vit erdhi Qedorllaomeri,

- edhe mbretëritë që ishinë bashkë me atë, edhe u ranë Refaimvet ndë Ashtaroth-karnaim, edhe Zuzimvet ndë Ham, edhe Emimet ndë Sa-
 6 bi-kiriathaim, Edhe Horitëvet ndë malt t'atyre Siir, gjer ndë El-faran, që është aferë
 7 shkretëtirësë. Edhe ukthyenë e erthnë ndë En-mishpatë, që është Kadeshi, edhe i ranë gjithë vëndit t' Amalikut, edhe Amoritëvet që rrininë ndë Hasason-thamar.
- 8 Edhe dolli mbreti i Sodhomavet, edhe mbreti i Gomorravet, edhe mbreti i Admasë, edhe mbreti i Seboimvet, edhe mbreti i Bellasë, e-cila është Zoara, edhe bënë luftë
 9 kundr' atyreve ndë fushët të Siddimit, Kundrë Qedorllaomerit, mbretit t' Ellamit, edhe kundrë Tidallit, mbretit të kombevet, edhe kundrë Amarfelit, mbretit të Shenaarit, edhe kundrë Ariohut, mbretit t' Ellasarit; katrë
 10 mbretër kundrë pesëve. Edhe fusha e Siddimit ishte plot me puse pise. Edhe mbretërit' e Sodhomavet e të Gomorravet uthyen' e iknë, edhe ranë atje; edhe ata që mbetnë iknë ndë
 11 malt. Edhe muarrë gjithë gjën' e Sodhomavet e të Gomorravet, edhe gjithë ushqimet' e atyreve, edhe shkuanë. Muarrë edhe Llotnë, të birr' e të vëllajt t' Abramit, që rrinte ndë Sodhomat, edhe gjën' e atij, edhe shkuanë.
- 13 Edhe vate një nga ata që shpëtuanë, edhe i dha zë Abramit, Ebreut, i-cili rrinte ndaj lisavet të Mamri Amoritit, vëllajt të

- Eshkollit, edhe vëllajt t' Anirit, të-cilëtë ishinë
 14 të-kuvënduarë me Abramnë. Edhe Abrami kur dëgjoj se umuar rop i vëllaj, nxori njerëzit' e tij të-stërviturë, tre-qint e tetë-mbëdhjetë veta, të-cilëtë kishinë lindurë ndë shtëpit t'atij, edhe i ndoqi armiqtë gjer ndë Dan.
- 15 Edhe si i ndau të titë, uhoth kundr' atyreve natënë, ay edhe shërbëtorët' e tij, edhe i goditi, edhe i ndoqi ata gjer ndë Hoba, që
 16 bje mbë të-mëngjërë të Damaskësë. Edhe pruri prapë gjithë gjënë, edhe pruri prapë edhe Llotnë, të vëllan' e tij, edhe gjën' e atij, edhe gratë, edhe gjindjenë.
- 17 Edhe kur kthenej *Abrami* nga prishja e Qedorllaomerit, edhe të mbretërvet që ishinë bashkë me atë, mbreti i Sodhomavet i dolli për të pritur' atë ndë fushët të Shabisë (që është Fusha e Mbretit).
- 18 Edhe Melqisedeku, mbreti i Salimit, pruri jashtë bukë edhe verë; edhe ay ishte prift
 19 i Perëndis' së-Lartë. Edhe e bekoj atë, e tha, I-bekuarë qoftë Abrami nga Perëndia i-Lartë,
 20 të, që është i zot' i qiellit edhe i dhëut; Edhe i-bekuarë qoftë Perëndia që të dha ndë dorët armiqt' e tu. Edhe *Abrami* i dha atij një tëdhjettë nga të-gjitha.
- 21 Edhe mbreti i Sodhomavet i tha Abramit, Ep-më njerëzitë, edhe gjënë merr-e për vetë
 22 tëhenë t' ende. Po Abrami i tha mbretit të Sodhomavet, Unë ngrita dorënë t' ime mbë

Zotinë, Perëndin' e-Lartë, të-zotin' e qiellit
 23 edhe të dheut, Se s' kam për të marrë një
 fill *peri* a një rrip sholle a çdo gjë tjetërë që
 është jotja, që të mos thuash, se Unë e bë-
 24 ra të-pasurë Abraminë; Përveç vetëmë asaj
 që hëngrë të-rinjtë, edhe pjesës' së njerës-
 vet që erdhë bashkë me mua, t' Anirit, t' E-
 shkollit, e të Mamrisë; këta let'a marrënë
 pjesën' e tyre.

Krye 15.

1 Pas këtyre punëve, erdhi fjala e Zotit te
 Abrami ndë të-faniturë, e i tha, Mos ufrikëso,
 Abram; unë jam mburonja jote; paga jote
 2 dotë jetë fort e-madhe. Edhe Abrami tha, O
 Zot, o Perëndi, ç' dotë më apç, kur unë po
 shkonj pa djalë, edhe ay që dotë ketë shtë-
 pinë t'ime është ky Eliezeri nga Damaska?
 3 Prapë Abrami tha, Na tek nukë më dhe fa-
 rë, edhe na tek dotë më trashëgonjë një *shër-
 bëtuar* që ka lindurë ndë shtëpit t'ime.
 4 Edhe na tek erdhi fjal' e Zotit tek ay, e
 i tha, Ky njeri nukë dotë jetë trashëgimtari
 yt; po trashëgimtari yt dotë jetë ay që dotë
 5 dalë nga të-përbrëndëshmet' e tua. Edhe e
 pruri atë jashtë, e i tha, Tashi vështro lart
 ndë qiellit, edhe numëro yjtë, ndë munç t'i
 numëronjç ata; edhe i tha atij, Kështu dotë
 6 jetë fara jote. Edhe ay besoj mbë Zotinë;
 edhe Zoti j'a numëroj atij për drejtëri

7 Edhe i tha atij, Unë jam Zoti që të nxora
 nga Ura e Halldhenjvet, që të të ap ty këtë
 8 dhe për trashëgim. Edhe ay tha. O Zot, o
 Perëndi, nga dot'a njoh se e kam për të
 9 trashëguar' atë? Edhe ay i tha atij, Merr-më
 një mëshqere tre vjeç, edhe një dhi tre vjeç,
 edhe një dash tre vjeç, edhe një turtuli, edhe
 10 një pëllump. Edhe ay mori për atë të-gjitha
 këto, edhe i çau ato ndë mest, edhe vuri
 gjithë-sicilënë copë kundruell shoqes' së saj;
 11 po zoqtë nuk' i çau. Edhe shpes t' egrë sbrit-
 12 në mbi kurmat, po Abrami i dëboj ata. Edhe
 mbë të-perënduarët të djellit, Abrami ra mbë
 një gjumë të rëndë; edhe na një tmer errë-
 sire së-madhe tek ra mbi atë.
 13 Edhe *Zoti* i tha Abramit, Me siguri t'a
 dish se fara jote dotë jetë e-huaj ndë një dhe
 që s' është i tyre, edhe dot' i bënë një shërbë-
 torë ata; edhe dot' i mundonjën' ata katër
 14 qint vjet. Po unë kombinë, tek i-cili dotë bë-
 nenë shërbëtorë, dot'a gjykonj; edhe pastaj
 15 dotë dalënë me gjë të-madhe. Po ti dotë
 shkosh te atërit' e tu me paqtim; dotë klli-
 16 tesh ndë varr me pleqëri të-mirë. Edhe mbë
 të-katërtinë bres dotë kthenenë këtu; sepse
 edhe nuk' është mbushurë paudhëria e A-
 moritëvet.
 17 Edhe kur perëndoj djelli, e uerr fort, na
 një kuminë që po nxirte tym, edhe një flakë
 zjarri, e-cila shkoj përrest atyre copavet.

18 Atë ditë Zoti bëri dhiatë me Abram në, dyke thënë, Farësë s' ate j'a dhashë këtë dhe, që prej lumit t' Egjyptësë e gjer ndë lumët të-
19 math, ndë lumët Evfrat; Kenitetë, e Kenizi-
20 tëtë, e Kadmonitëtë, E Hittitëtë, e Ferizitëtë, e
21 Rafaimëtë, E Amoritëtë, e Hanaanitëtë, e Gjer-
gjeshtëtë, e Jebusitëtë.

Krye 16.

1 Edhe Sara, gruaja e Abramit, nuk' i pillte fëmijë, edhe kishte një shërbëtore Egjyptiane
2 që quhej Agarë. Edhe Sara i tha Abramit, Na Zoti tek më bëri shterpë; hyrë, të lutem, te shërbëtoreja ime, mbase mos fitonj fëmijë me anë t' asaj. Edhe Abrami j'a dëgjoj fjalën Sarësë.
3 Edhe Sara, gruaja e Abramit, mori Agarën, Egjyptianenë, shërbëtoren' e saj, dhjetë vjet pas të-ndënjurit të Abramit ndë dhet të Hanaanit, edhe j'a dha Abramit, burrit të
4 saj, që të ishte grua e atij. Edhe ay hyri te Agara, edhe ajo umbars; edhe kur pa se umbars, e zonj' e asaj çpërnderonej përpara syvet t' asaj. Atëhere Sara i tha Abramit, Paudhëria që më bënetë mua është detyrë mbë ty; Unë të dhashë shërbëtorenë t' ime ndë gjith; edhe kur pa ajo se umbars, unë uçpërnderova përpara syvet t' asaj; Zoti letë gjithë konjë ndë mest meje e teje. Po Abrami i tha Sarësë, Na shërbëtoreja jote tek është ndë

dorët t' ënde, bën-i asaj si të jet' e-pëlqyerë ndë syt të tu. Edhe Sara e përdori atë ashpërë, edhe ajo iku nga syt' e asaj.
7 Po ëngjëlli i Zotit e gjeti atë për anë një burimi uji ndë shkretëtirët, për anë burimit që është mb' udhët për ndë Shur; Edhe i tha, Agarë, shërbëtore e Sarësë, nga vjen? e ku po vete? Edhe ajo i tha, Po ikënj nga syt' e
9 Sarësë, s' ime zonje. Edhe ëngjëlli i Zotit i tha asaj, Kthehu te jot' zonjë, edhe upërunj
10 ndënë duart t' asaj. Pastaj ëngjëlli i Zotit i tha asaj, Dotë shumonj fort farënë t' ënde, kaqë sa të mos numëronetë dot nga shumica. Edhe ëngjëlli i Zotit i tha asaj, Na ti tek je me barrë, edhe dotë pjellç djalë, edhe dot' j'a quanç emërinë Ismail, sepse Zoti dëgjoj
12 shtrengimnë t' ënt. Edhe ky dotë jetë posi një gomar i-egërë ndër mest të njerësvet; dora e atij dotë jetë kundrë të-gjithëve, edhe dora e të-gjithëve kundr' atij; edhe dotë rrijë përpara syvet të gjithë vëllezërvet të tij.
13 Edhe Agara e quajti emërin' e Zotit që i fliste asaj, Ti je Perëndi që sheh; sepse tha, A nukë pashë edhe unë këtu atë që më sheh?
14 Përandaj ay pus uquajt Bir-llahai-roi*); na tek është ndër mest të Kadeshit e të Beredit.
15 Edhe Agara i polli Abramit një djalë; edhe Abrami e quajti emërin' e të birt, që i polli Agara, Ismail.

*) Pusi i të-gjallit që sheh.

16 Edhe Abrami ishte tetë-dhjet' e gjashtë vjeç, kur Agara i polli Abramit Ismailnë.

Krye 17.

1 Edhe kur ishte Abrami nëntë-dhjet' e nëntë vjeç, Zoti i uduk Abramit, e i tha, Unë jam Perëndia Gjithëpushtetësi; ecë përpara
2 meje, edhe bënu i-mbaruarë. Edhe dotë bënj dhiatënë t'ime ndër mest meje e teje, edhe dotë të shumonj fort tepërë.

3 Edhe Abrami ra mbi faqet të tij; edhe
4 Perëndia i foli atij, dyke thënë, Sa prej meje, na dhiata ime është me ty, edhe dotë bë-
5 nesh atë i shumë kombeve. Edhe emëri yt nukë dotë quhetë më Abram, po emëri yt dotë jetë Abraam; sepse të bëra atë të shu-
6 më kombeve. Edhe dotë të shtonj fort tepërë, edhe dotë bënj kombe prej teje, edhe dotë
7 dalënë mbretër prej teje. Edhe dotë vë dhiatënë t'ime ndër mest meje e teje edhe të farësë s'ate pas teje ndë brezat t'atyre për dhjatë të-përjetëshme, që të jem Perëndi te
8 ti edhe te fara jote pas teje. Edhe dot'ap ty edhe farësë s'ate pas teje dhenë ndë të-cilët rri i-huaj, gjithë dhen' e Hanaanit, për trashëgim të-përjetëshm; edhe dotë jem Perëndia i atyreve.

9 Edhe Perëndia i tha Abraamit, Edhe sa për tynë, ti dotë ruanjç dhiatënë t'ime, ti edhe
10 fara jote pas teje ndë brezat të tyre. Këjo

është dhiata ime, që dotë ruani ndër mest meje e juve, edhe të farësë s'ate pas teje; ndër mest t'uaj çdo mashkull dotë rrethpri-
11 tetë. Edhe dotë rrethpriteni ndë misht të lafshës' s'uaj, edhe këjo dotë jetë për shënjë të
12 dhiatësë ndër mest meje e juve. Edhe tetë ditsh djalë dotë rrethpritetë ndër ju, çdo mashkull ndë brezat t'uaj, si ay që ka lindurë ndë shtëpit, *ashtu* edhe ay që ëshfë blerë me ergjënt prej ndonjëj të-huaji, i-cili nuk'
13 është prej farësë s'ate. Pa fjalë ay që ka lindurë ndë shtëpit t'ënde, edhe ay që është blerë me ergjëndinë t'ënt, duhetë të rrethpritetë; edhe dhiata ime dotë jetë ndë misht
14 t'uaj për dhiatë të-përjetëshme. Po mashkulli i-parrethprerë, të-cilit mishi i lafshësë nuk' i rrethpritetë, ay shpirt dotë vdiuretë nga mezi i gjindjesë s'uaj; *sepse* prishi dhiatënë t'ime.

15 Edhe Perëndia i tha Abraamit, Sa për Sarënë, gruanë t'ënde, nukë dot' j'a quajnç më emërinë Sarë, po Sarrë*) dotë jet' emëri
16 i asaj. Edhe dota bekonj atë, edhe dotë të ap djalë nga ajo; po, dot'a bekonj atë, edhe dotë bënetë *mëmë* kombeve; mbretër gjindjeve dotë dalënë prej asaj.

17 Atëhere Abraami ra mbi faqet të tij, edhe qeshi, e tha ndë zëmëret të tij, Një qint vjeç burri dot' i lintnjë *djalë?* edhe Sarra, nëntë-

*) Prinsesë, Zonjë.

- 18 dhjetë vjeç grua, dote pjellë? Edhe Abraami
i tha Perëndisë, Rroftë Ismaili përpara teje!
- 19 Edhe Perëndia tha, Po, me të-vërtetë Sarra, gruaja jote, dotë të pjellë djalë edhe dot' j'a quanjç atij emërinë Isaak; Edhe dotë vë dhiatënë t'ime me atë për dhiatë të-përrjetëshme, edhe me farën' e atij pas atij.
- 20 Edhe për Ismailinë, të dëgjova; na tek e bekova atë, edhe dot'a shtonj, edhe dot'a shumonj fort tepërë; dot' i lintnjënë dy-mbëdhjetë zotërinj, edhe dot' e bënë atë komp të-math. Po dhiatënë t'ime dot'a vë me Isaaknë, që dotë të pjellë Sarra, mbë këtë kohë, motinë që vjen. Edhe si mbaroj të-foluritë me atë, Perëndia hipi lart nga Abraami.
- 23 Edhe Abraami mori Ismailinë, të birrë, edhe gjith'ata që kishinë lindurë ndë shtëpit të tij, edhe gjith'ata që kishte blerë me ergjënt të tij, çdo mashkull nga njerëzit'e shtëpis' s' Abraamit, edhe u rrethpreu mishin' e lafshës' s' atyre ndë gjithatë ditë, sikundrë
- 24 Perëndia i tha atij. Edhe Abraami ishte nëntëdhjet' e nëntë vjeç, kur urrethpre ndë misht të lafshës' së tij. Edhe Ismaili, i bir' i ati, ishte tetë-mbë-dhjetë vjeç, kur urrethpre ndë misht të lafshës' së ti. Gjithatë ditë urrethpre Abraami edhe Ismaili, i bir' i atij. Edhe gjithë njerëzit' e shtëpis' s' atij, ata që kishinë lindurë ndë shtëpit t'atij, edhe ata që ishinë blerë me ergjënt nga kombe të-huaj, urrethprenë bashkë me atë.

Krye 18.

- 1 Edhe Zoti i uduk ati ndaj lisavet të Marrisë, tek po rrinte ndë derët të tendësë ndë
2 vapët të ditësë. Edhe ay ngriti syt' e tij, edhe pa, edhe na tre burra tek po rrininë përpara atij; edhe si i pa ata, usul nga der' e tendësë që t'u dallë përpara, edhe unji vetë-
3 hen' e ti gjer përdhje; Edhe tha, Zoti im, ndë kam gjeturë hir përpara syvet të ty, mos ikë,
4 të lutem, nga shërbëtori yt. Letë bjenë, të lutem, pak ujë, edhe lani këmbët t' uaj, edhe
5 prëhi ndënë list; Edhe unë dotë bje pakëzë bukë, edhe forconi zëmërenë t' uaj, pastaj dotë shkoni; sepse për këtë shkuatë nga shërbëtori juaj. Edhe ata thanë, Bëj kështu, si the.
- 6 Edhe Abraami vate me vrap ndë tendët te Sarra, edhe tha, Çpejto, e ngjish tri masa mjelli të-mirë, edhe bëj kuleç. Edhe Abraami vate me vrap ndër lopët, edhe mori një viç të-kërtinjtë e të-mirë, edhe ja dha shërbëtorit; edhe ay çpejtoj t'a bënte gati.
- 8 Pastaj mori gjalpë e qumësht, edhe viçinë që kishte bërë gati, edhe i vuri përpara atyreve; edhe ndënji afërë atyreve, ndënë list; edhe ata hëngrrë.
- 9 Edhe i than' atij, Ku është Sarra, gruaja
10 jote? Edhe ay tha, Na, ndë tendët. Edhe ay tha, Pa fjalë dotë kthenem te ti pas një moti ndë këtë kohë; edhe na, Sarra, gruaja jo-

- te, dotë ketë bir. Edhe Sarra dëgjoj ndë derët të tendësë, që ishte prapa atij.
- 11 Edhe Abraami e Sarra ishinë pleq *edhe* të-shkuarë ndë moshët; Sarrësë i kishinë
- 12 mbeturë të-ardhurat' e gravet. Edhe Sarra qeshi me vetëhen' e saj, dyke thënë, Passi umblaka, a dot'a kem *këtë* gëzim, kur edhe im
- 13 zot është plak? Edhe Zoti i tha Abraamit, Përse qeshi Sarra, dyke thënë, Passi umblaka unë, a dotë piell me të-vërtetë? A ka gjë që s' munt *t'a bënë* Zoti? pas një viti, ndë kohët që ndava, dotë kthenem tek ti, edhe
- 15 Sarra dotë ketë bir. Atëhere Sarra mohoj, e tha, Nukë qesha; sepse pati frikë. Edhe ay tha, Jo, po qeshe.
- 16 Edhe burratë ugritnë q' andej, edhe j'a mbajtnë për ndë Sodhoma; edhe Abraami
- 17 doli bashkë me ata që t'i përcillte. Edhe Zoti tha, A dot'a fsheh nga Abraami atë që po
- 18 bënj, Kur Abraami pa fjalë dotë bënetë një komp i-math e i-fortë, edhe gjithë kombet' e
- 19 dheut dotë bekonenë mb'atë? Sepse e njoh atë, se dotë porositnjë bijt' e tij edhe shtëpin' e tij pas vetëhes' së tij të ruanjënë udhën' e Zotit, që të bënjënë drejtëri e gjyq; që të bjerë Zoti mbi Abraamnë gjithë sa foli
- 20 për atë. Edhe Zoti tha, Me-qënë-që klithma e Sodhomavet edhe e Gomorravet është fort e-madhe, edhe me-qënë-që faji i atyre është
- 21 fort i-rëndë, Dotë sbres tashi, edhe dotë shoh

- ndë punuanë tej-për-tej pas klithmësë që vjen tek unë; ndë mos, po t'a di.
- 22 Edhe burratë iknë q' andej, edhe vanë drejt për ndë Sodhoma; po Abraami edhe po
- 23 qëndronte përpara Zotit. Edhë Abraami uafërua e tha, *Mos* dotë prishç të-drejtinë
- 24 bashkë me të-ligunë? Mundetë të ketë pesëdhjetë të-drejtë ndë qytett; dot' e prishç edhe nukë dot' e ndjesli vëndinë për të pesëdhjetë
- 25 të-drejtëtë që janë nd' atë? Qoftë lark prej teje të bënjç të-këitillë punë, të vrasç të-drejtinë bashkë me të-ligunë, që kështu i-drejtiti të jetë posi i-ligu; qoftë lark prej teje; Gjykatësi i gjithë dheut a nukë dotë bënjë *gjyq*
- 26 të-drejtë? Edhe Zoti tha, Ndë gjeça pesëdhjetë të-drejtë ndë qytett të Sodhomavet, atëhere dot'a ndjenj gjithë vëndinë për ata.
- 27 Edhe Abraami upërgjjeq e tha, Na tashi tek kuxova t'i flas Zotit t'im, ndonëse jam
- 28 pluhur' edhe hi; Mundetë të mungonjënë pesë *veta* nga të pesëdhjetëtë të-drejtë; dot' e prishç gjithë qytetnë, sepse mungojnë pesë *veta*? Edhe Zoti tha, Nukë dot' e prish atë, ndë gjeça atje dyzet e pesë *të-drejtë*.
- 29 Edhe *Abraami* i foli edhe prapë atij, edhe tha, Mundetë të gjëndenë atje dyzet *të-drejtë*. Edhe *Zoti* tha, Nukë dot'a prish atë, për hirin' e të dyzetvet.
- 30 Edhe *Abraami* tha, Letë mos zëmëronetë Zoti, ndë folça *edhe më*; mundetë të ket' atje

tri-dhjetë. Edhe ay tha, Nukë dot'a prish atë, ndë gjeça atje tri-dhjetë.

31 Edhe Abraami tha, Na tashi tek kuxova t'i flas Zotit; mundetë të gjëndenë atje njëzet. Edhe ay tha, Nukë dot' e prish, për hirin' e të njëzetvet.

32 Edhe *Abraami* tha, Letë mos zëmëronetë Zoti, edhe dotë flas vetëmë edhe këtë herë; mundetë të gjëndenë atje dhjetë. Edhe *Zoti* tha, Nukë dot'a prish, për hirin' e të dhjetëvet.

33 Edhe Zoti iku, posa pushoj së foluri me Abraamnë; edhe Abraami ukthye ndë vëntt të tij.

Krye 19.

1 Edhe të dy ëngjëjtë erdhë ndë Sodhomat mbrëmanet; edhe Lloti po rrinte ndë portët të Sodhomavet; edhe Lloti i pa ata; edhe ungrit të dilte përpara atyre; edhe unji faqen' e tij gjer përdhe, E tha, Na, o zotërinjt' e mi, kthehuni, u lutem, ndë shtëpit të shërbëtorit t' uaj, edhe rrini tërë natënë, e lani këmbëtë t' uaj; edhe ndë mëngjest si të ngrihi dotë shkoni udhësë s' uaj. Edhe ata thanë, Jo, po 3 mb' udhët *këtu* dot'a shkojmë tërë natënë. Edhe passi i shtrëngoj ata tepërë, ukthyenë tek ay, edhe hynë ndë shtëpit t' atij; edhe u bëri atyreve gosti, edhe poqi kuleç pa brumë, edhe hëngrrë.

4 Po përpara se të flininë, burrat' e qytetit, burrat' e Sodhomavet, të-rinj edhe pleq, gjithë gjindja prej çdo shtëpishte, qerthëlluanë shtëpinë; Edhe i thërrisninë Llotit, e i thoshinë, Ku janë ata burra që hynë sonte tek ti? nxir-i ata ndër ne që t'i njohëmë. 6 Atëhere Lloti doli tek ata ndë derët, edhe 7 mbylli derënë prapa tij, E tha, U lutem, o 8 vëllezërit' e mi, mos bëni këtë të-keqe. Na tek kam dy bija, që s' kanë njohurë burrë; u lutem, let' u'a nxjer ato jashtë, edhe bëni me ato si të jetë mirë ndër syt t' uaj; vetëmë këtyre njerësve mos u bëni gjë *të-keqe*; sepse për këtë erdhë ndënë hijet të shtëpisë 9 s' ime. Edhe ata thanë, Hi qu prapa: Edhe thanë, Ky i-huaj erdhi të rrijë *këtu*; edhe kërkon të jet' edhe gjykatës; tashi dotë sillemi më keq me ty, se me ata. Edhe e shtrënguanë keq njerinë, po, Llotinë, edhe uafëruanë që të 10 thyeninë derënë. Po burratë ndejtinë duart' e tyre, edhe e hoqnë Llotinë ndë shtëpit për ranë vetëhes' së tyre, edhe mbyllnë derënë. 12 Po ata njerës që ishinë ndë derët të shtëpisë i goditnë me verbësirë; që nga i-vogëli e gjer te i-madhi, kaqë sa ulothnë dyke kërkuarë derënë. 12 Edhe burrat' i thanë Llotit, A-ke këtu tja-tërë njeri? dhëndërr, a bij, a bija, a çdo tjetërë njeri që ke ndë qytet, nxir-i nga ky vënt; 13 Sepse neve po e prishëmë këtë vënt, sepse

- klithma *kundr'* atyreve ushumua përpara Zotit, edhe Zoti na dërgoj që t'a prishëm' atë.
- 14 Dolli pra Lloti, edhe u foli dhëndurrëvet të tij, që ishinë për të umartuarë me të bijat' e atij, e tha, Ngrihi, dilni nga ky vënt; sepse Zoti po prish qytetnë. Po dhëndurrëvet të tij uduk se sikur tallej,
- 15 Edhe kur usbardhëllua, ëngjëjt' e nxituanë Llotinë, dyke thënë, Ngreu, merr gruanë t'ënde, edhe të dy t'ët bija që gjendenë këtu; që të mos humbesh *edhe ti* ndë paudhërit të qytetit. Po passi mënonte, rroknë dorën' e atij, edhe dorën' e gruas' s'atij, edhe duart' e të dy bijavet i' atij, (sepse i udhëmp Zotit për atë,) e e nxuarr' atë, edh' e vunë jashtë qytetit. Edhe kur i nxuarrë ata jashtë, *nyëri nga ata* tha; Shpëto jetënë t'ënde; mos vështro prapa teje, as mos rrish *asgjëkundi* ndë gjithë *këtë* fushë; ikë ndë malt, që të mos humbesh. Edhe Lloti u tha atyre, Mos kështu, o Zot, *të lutëm*; Na shërbëtori yt tek gjeti hir përpara teje, edhe madhove përdëllimnë t'ënt, që tregove tek unë, dyke shpëtuarë jetënë t'ime; po unë s' munt të ikënj ndë malt, *e kam frikë* se mos më harrinjë e-keqeja, edhe vdes.
- 20 Të lutem, na ky qytet është afërë që të ikënj atje, edhe është i-vogëlë; letë shpëtonj atje, (a nuk' është i-vogëlë?) edhe dotë rronjë shpirti im. Edhe *Zoti* i tha atij, Na tek të dëgjova edhe për këtë punë, të mos e prish qytetnë

- 22 për të-cilinë fole; Çpejto, e shpëto atje; sepse nukë dotë munt të bënj asgjë, gjersa të veç atje. Përandaj emëri i qytetit uquajt Zoarë*).
- 23 Edhe djelli lindi mbi dhet, kur hyri Lloti ndë Zoarë.
- 24 Atëhere Zoti lëshoj mbi Sodhomat e mbi Gomorrat shi squfuri e zjarri prej Zotit nga qielli; Edhe prishi ata qytete, edhe tërë fushënë, edhe gjithë vëndësit' e qytetevet, edhe çdo që rritetë mbi dhet. Po gruaja e atij prapa atij vështroj prapa, edhe ubë shtyllë kripe.
- 27 Edhe Abrami mëngoj ndë mëngjest *e erdhi* nd' atë vënt ku pat ndënjurë përpara Zotit; Edhe hodhi sytë drejt Sodhomavet e Gomorravet, edhe drejt gjithë vëndit të fushësë, edhe pa, edhe na tek po hipënte tym nga dheu posi tym kumine.
- 29 Kështu pra, kur prishi Perëndia qytetet' e fushësë, Perëndisë i ra ndër mëntt Abraami, edhe Llotin' e nxori nga mezi i prishjesë, kur prishi qytetetë, ndë të-cilët rrinte Lloti.
- 30 Edhe Lloti dolli nga Zoara, e hipi e ndënji ndë malt, edhe të dy të bijat' e atij bashkë me atë; sepse pat frikë të rrinte ndë Zoarë; edhe ndënji ndë një shpellë ay edhe të dy të bijat' e atij.
- 31 Edhe m' e-madhja i thotë më së-vogëlësë, Ati ynë është plak, edhe njeri nukë ka
- *) i-vogëlë.

mbi dhet që të hynjë ndër ne pas mënyrës'
 32 së gjithë botësë; Eja, le'a bëjmë atinë t'ënë
 të pijë verë, edhe letë flemë bashkë me atë,
 33 që të ruajmë farë nga ati ynë. E bënë pra
 t'an' e tyre të pije verë atë natë; edhe hyri
 m' e-madheja, e flejti bashkë me t'anë; po
 ay nukë kupëtoj as kur ra ajo, as kur u-
 34 ngrit. Edhe mbë të nesërmet i tha më e-ma-
 dheja më së-vogëlësë, Na unë tek flejta dje
 natënë bashkë me atinë t'ënë: le'a bëjm' atë
 të pijë verë edhe sonte, edhe hyrë ti, e bjerë
 bashkë me atë, që të ruajmë farë nga ati
 35 ynë. E bënë pra t'an' e tyre të pijë verë edhe
 atë natë; edhe ungrit m' e-vogëla, e flejti ba-
 shkë me atë; po ay nukë kupëtoj as kur ra
 36 ajo, as kur ungrit. Kështu umbarsnë të dy
 37 të bijat' e Llotit prej atit të tyre. Edhe m' e-
 madheja polli djalë, edhe emërin' e ati e
 quajti Moab; ky është i ati i Moabitëvet gjer
 38 mbë këtë ditë. Pastaj polli djalë edhe m' e-
 vogëla, edhe e quajti emërin' e atij Ben-ammi;
 ky është i ati i Ammonitëvet gjer mbë këtë
 ditë.

Krye 20.

1 Edhe Abraami unis që andej për ndë a-
 nët të mesditësë, edhe ndënji ndër mest të
 Kadeshit e të Shurit; edhe ndënji i-huaj ndë
 2 Gjerarë. Edhe Abraami tha për Sarrënë, gru-
 an' e tij, Këjo është ime motërë. Edhe Abi-

melehu, mbreti i Gjerarësë, dërgoj, e e mori
 3 Sarrënë. Po Perëndia erdhi tek Abimelehu
 natënë nd' ëndërrë, e i tha, Na ti tek vdes për
 punë të guasë që more; sepse ajo është
 4 martuarë me burrë. Edhe Abimelehu nuk' i-
 shte afëruarë tek ajo; edhe tha, Zot, a dotë
 5 vrasç një komp të-drejtë? A nukë më tha
 ay vetë, Këjo është ime motërë? Edhe ajo,
 vet' ajo tha, Ky është im vëlla. Me të-kthje-
 llëtë të zëmërsë s'ime, edhe me të-drejtë të
 6 duarvet të mia e bëra këtë. Edhe Perëndia i
 tha atij nd' ëndërrë, Po, un' e di se me të-
 kthjellëtë të zëmërsë s'ate e bëre këtë; an-
 daj edhe unë të ndalova të mos fëjenjç kun-
 dre meje; për këtë nukë të lashë t'a ngasç
 7 atë. Tashi pra kthe-j'a gruanë burrit të saj;
 sepse është profit, edhe dotë lutetë për ty,
 edhe dotë rronjç; po ndë mos j'a dhënjç atë
 prapë, t'a dish se pa fjalë dotë vdesç, ti, edhe
 gjithë të-tutë.

8 Edhe Abimelehu ungrit çpejt ndë mën-
 gjest, edhe thirri gjithë shërbëtorët' e tij, edhe
 i rrëfeu gjithë këto gjërëra ndë veshët t'a-
 9 tyre; edhe njerëzit' ufrikësuanë fort. Pastaj
 Abimelehu thirri Abraamnë, e i tha, Ç' është
 këjo që na bëre? edhe ç' faj të kam bërë unë
 ty, që prure mbi mua e mbi mbretërit t' ime
 faj të-math? bëre një punë tek unë që nukë
 10 duhej të bënej. Edhe Abimelehu i tha Abra-
 11 amit, Ç' pe, që bëre këtë punë? Edhe Abra-

- ami tha, Sepse unë umenduashë, Me të-vërtetë s' ka frikë Perëndie ndë këtë vent; edhe
12 dotë më vrasënë për gruanë t' ime. Po me gjithë këto ajo është me të-vërtetë ime motërë, bij' e t' im et, po jo bij' e s' im' mëje;
13 edhe ubë gruaja ime. Edhe kur më bëri Perëndia të dal nga shtëpia e t' im et, i thash' asaj, Këtë të-mirë të më bënç mua; mbë çdo vënt që të vemi, thuaj për mua, Ky është im vëlla.
- 14 Edhe Abimelehu mori dhën, e qe, e shërbëtorë, e shërbëtore, e j'a dha Abraamit; i
15 dha prapë edhe Sarrënë, gruan' e atij. Edhe Abimelehu tha, Na dheu im tek është për-
16 para teje; rri ku të të pëlqenjë. Edhe Sarrës' i tha, Na tek i dhashë një mijë copë ergjëndi t' yt vëllaj; na ay është për ty një mbulesë sysh ndër gjith' ata që janë bashkë me ty; edhe përpara gjithëve dotë jesh e-drej-tëruarë.
- 17 Edhe Abraami i ulut Perëndisë; edhe Perëndia shëroj Abimelehunë, edhe gruan' e atij, edhe shërbëtoret' e atij, edhe puallnë fëmijë.
- 18 Sepse Zoti kishte mbyllurë gjithë shtratetë ndë shtëpit t' Abimelehut për punë të Sarrësë, gruas' s' Abraamit.